

RELACION
PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN 66/2016 “PËR SHËRBIMET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË””

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë””, propozuar nga ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka për qëllim të përafrojë tërësisht parashikimet e ligjit në fjalë me Direktivën 2006/123/KE “Për shërbimet në tregun e brendshëm” (e njohur si “Direktiva e Shërbimeve”), duke krijuar kështu premisat e ushtrimit të lirisë së ofrimit të shërbimeve ndërkufitare në Republikën e Shqipërisë.

Projektligji, i propozuar ashtu si dhe vetë ligji në të cilin do të ndërhyhet, ofron një rregullim horizontal, i cili dikton më tej ndryshimet e nevojshme sektoriale me qëllim garantimin e ofrimit të shërbimeve sa më cilësore nga ofruesit e shërbimeve për përfituesit.

Projektligji i propozuar, nëpërmjet **përafrimit të plotë të ligjit 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë” me Direktivën 2006/123/KE për shërbimet në tregun e brendshëm**, ku dispozitat e Ligjit për Shërbimet do t’i nënshtrohen një rishikimi gjithëpërfshirës për të siguruar përputhjen e plotë me Direktivën e BE-së, me synim identifikimin dhe rishikimin e të gjitha dispozitave që aktualisht ndryshojnë plotësisht dhe pjesërisht nga parashikimet e Direktivës do të mundësojë dhe arritjen e sa më poshtë:

- **Brendësimin e koncepteve të rëndësishme të Direktivës dhe përmirësimin/qartësimin e dispozitave ekzistuese në lidhje me të drejtën e vendosjes dhe mbrojtjen e përfituesve të shërbimeve** - Ndryshimet ligjore do të konsistojnë në përfshirjen e koncepteve thelbësore aktualisht të pa përfshira në përmbajtjen e Ligjit për Shërbimeve por gjithashtu ndërhyrja do të ketë si fokus rishikimin e parashikimeve ekzistuese ligjore dhe qartësimin apo saktësimin e tyre;
- **Krijimin e premisave për ofrimin e shërbimeve ndërkufitare me shtetet e Bashkimit Evropian** - Rishikimet e Ligjit për Shërbimet do të prezantojnë dhe organizojnë kuadrin rregullator për ofrimin e shërbimeve ndërkufitare ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve anëtare të BE-së. Me finalizimin e këtij objekti do mund të ndërmerren ndryshimet e tjera nevojshme në legjislacionin e posaçëm kuadër dhe atë sektorial. Kjo ndërhyrje në afatgjatë do të thjeshtëzojë më tej dhe nxisë ofrimin e shërbimeve nga operatorë të BE në Shqipëri;
- **Përfshirjen e parashikimeve kuadër në lidhje me bashkëpunimin administrativ me vendet e Bashkimit Evropian si dhe ndërveprimi me Sistemin IMI** - Kjo predispozitë do të përmirësojë dhe do të rrisë efikasitetin në shkëmbimin e informacionit ndërmjet

autoriteteve rregullatorë, me synim uljen e barrës burokratike, duke lehtësuar mbikëqyrjen dhe zbatimin më të mirë të shërbimeve ndërkufitare dhe duke siguruar përafrimin me praktikatat administrative të BE-së;

- **Krijimin i kushteve të përafrimit të legjislacionit sektorial dhe vendosjen e kërkesave të unifikuara në ofrimin e shërbimeve në kuadër të integritetit** - Ndërhyrjet që do të pasojnë përafrimin e ligjit në legjislacionin e posaçëm dhe atë sektorial do të jenë të unifikuara dhe koordinuara sipas parimeve të vetë Ligjit për Shërbimet;
- **Realizimi i masës përkatëse në PKIE 2024-2026, brenda vitit 2025** - Ndryshimet ligjore të propozuara do të mbështesin realizimin e masës strategjike të përshkruar në PKIE 2024-2026, duke siguruar që harmonizimi i plotë me Direktivën 2006/123/KE i Ligjit të Shërbimeve, të arrihet brenda afatit të parashikuar, deri në vitin 2025.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji i propozuar është parashikuar në programin analitik të projektaktevetë miratuara për Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Ky akt është parashikuar edhe në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 11.1.2024 (PKIE).

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është angazhuar në përgatitjen e këtij projektligji, në përputhje me fushën e veprimtarisë shtetërore që ka në kompetencë, si organ përgjegjës për hartimin e politikave ekonomike të vendit, si dhe ndërmarrjen e reformave me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit, duke krijuar kështu bazat për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe thithjen e investimeve të huaja.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë””, është hartuar në kuadër të punës së ndjekur deri tani për përafrimin e legjislacionit shqiptar në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime me *acquis*-në e BE në këtë fushë dhe është pjesë e planit të veprimit të hartuar dhe miratuar nga qeveria Shqiptare për këtë qëllim.

Gjithashtu, nevoja për përafrimin e legjislacionit në këtë fushë dhe transpozimi i plotë Direktivës së Shërbimeve është parashtruar vazhdimisht edhe nga institucionet e Bashkimit Evropian, sidomos në raportet e progresit të Komisionit Evropian, si edhe në takimet periodike të nënkomitetit për tregun e brendshëm.

Gjatë proceseve *screening* dhe PKIE qeveria shqiptare është zotuar të realizojë përafrimin e plotë të ligjit 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë” me Direktivën e Shërbimeve brenda vitit 2025.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji që propozohet për miratim do të ketë vendin e tij në rendin juridik shqiptar, i cili përcaktohet nga neni 116/1 i Kushtetutës.

Baza ligjore për propozimin e këtij projektligji, sipas hierarkisë ligjore është përmbledhur si më poshtë:

- nenin 81 të Kushtetutës, i cili përcakton se: “...*të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës*”.
- nenin 26, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, i cili përcakton se: “*Projektaktet, që u përkasin institucioneve të tjera qendrore, në varësi të Kryeministrit ose të ministrit përkatës, paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, me propozimin e Kryeministrit ose të ministrave përkatës*”.
- pikën 3, të rregullores së Këshillit të Ministrave, miratuar me vendimin nr. 584, datë 28.8.2003, i ndryshuar, sipas së cilës: “*Të drejtën për të propozuar projektakte për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, e kanë Kryeministri dhe çdo ministër*”.

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, veçanërisht nenin 11 dhe nenin 49.

Projektligji i propozuar mbështetet në nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Gjithashtu ky projektligj është në përputhje me parashikimet në nenet 49-59, të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre për përafrimin e legjislacionit shqiptar në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë së ofrimit të shërbimeve me *acquis-në e BE-së* në këtë fushë.

Projektligji i propozuar krijon një kuadër të qëndrueshëm ligjor për të gjithë procesin e rishikimit të legjislacionit sektorial, me qëllim përafrimin e tij me *acquis-në e BE-së* për të drejtën e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve.

Projektligji i propozuar është në përputhje të plotë me Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Projektligji i propozuar ashtu si vet ligji 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë”, është një akt juridik me natyrë horizontale që synon harmonizimin e të gjitha legjislacioneve sektoriale në fushën e të drejtës së themelimit dhe ofrimit të shërbimeve në Republikën e Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë””, synon të përafrojë plotësisht legjislacionin shqiptar në fushën e të drejtës së themelimit dhe lirisë së ofrimit të shërbimeve me *acquis*-në e BE-së në këtë fushë, konkretisht Direktivën 2006/123/KE, “Për shërbimet në tregun e brendshëm”.

Në tabelën e përputhshmërisë, bashkëlidhur këtij relacioni, janë identifikuar një sërë parashikimesh të Direktivës së Shërbimeve të cilat për shkak të rrethanave të posaçme në kohën e implementimit të ligjit, janë lenë jashtë fokusit të harmonizimit. Duke konsideruar avancimin e ndjeshëm të Shqipërisë në hapat e integritetit, lind domosdoshmëria e përshtatjes së pjesës së mbetur të parashikimeve të direktivës.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë””, synon përfshirjen e parashikimeve të patranspozuara të Direktivës së Shërbimeve në ligjin ekzistues.

Rrjedhimisht, si një akt juridik me efekt horizontal, parashikimet e këtij ligji do të reflektohen gradualisht edhe në legjislacionin përkatës sektorial.

Projektligji i propozuar përmban gjithsej 14 nene, përmbajtja e të cilave parashtrohet në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë vijon:

- Neni 1, 2 dhe 3 parashikojnë qëllimin e projektligjit të riformuluar, duke parashikuar zbatueshmërinë e ligjit edhe për ushtrimin e aktiviteteve ndërkufitare për ofruesit e shërbimeve në Republikën e Shqipërisë, përcaktojnë perimetritin e shërbimeve të përjashtuara si dhe adresojnë marrëdhëniet e Ligjit për Shërbimet me ligjet e posaçme, gjatë zbatimit të tyre;

- Neni 4 përshtat dhe shton përkufizime të reja në kuadër të përafrimit të plotë të Direktivës së Shërbimeve, rritet te Shqipërisë si vend i ardhëm anëtar i BE, dhe kuptueshmërisë më të mirë të ligjit;
- Nenet 5, 6, 7, 8 dhe, 9 përmirësojnë dhe përafrojnë tërësisht dispozitat ekzistuese në kuadër të drejtës së vendosjes dhe ushtrimit të aktivitetit nga ofruesit e shërbimeve si dhe parashikimet e përgjithshme për autorizimet;
- Neni 10 sjell si risi përfshirjen e kreut për lirinë e ofrimit të shërbimeve ndërkufitare, duke i lejuar bizneset dhe profesionistët të ofrojnë shërbimet e tyre në shtetet anëtare pa u përballur me kufizime të pajustificuara.
- Neni 12 rikoncepton kreun IV të ligjit duke përafuar plotësisht parashikimet me ato të Direktivës së Shërbimeve. Tashmë ky kre riemërtohet si “Të drejtat e përfituesve dhe cilësia e shërbimeve” dhe përbëhet nga dy seksione. Seksioni i parë “Të drejtat e përfituesve të shërbimeve”, i bazuar në tekstin ekzistues të ligjit dhe me shtesa dhe ndryshime në përputhje me parashikimet e direktivës. Seksioni i dytë “Informacioni për ofruesit dhe cilësia e shërbimeve”, në të cilin prezantohen koncepte të reja si:
 - parashikimet për garancitë profesionale – ofruesit e shërbimeve duhet të kenë sigurime ose garanci të përshtatshme për të mbuluar çdo detyrim të mundshëm që rrjedh nga shërbimet e tyre. Kjo siguron që konsumatorët të mbrohen në rast të ndonjë dëmi ose dëmtimi të shkaktuar nga shërbimet e ofruara. Garancitë e lëshuara nga vendet e BE do të jenë të barasvlershme me ato vendaset;
 - parashikimet për aktivitetet shumedisiplinore – në këto dispozita përcaktohet qartazi se ofruesit nuk duhet të nënshtrohen kërkesave që i detyrojnë ata të ushtrojnë ekskluzivisht një veprimtari të caktuar ose që kufizojnë ushtrimin e përbashkët ose në partneritet të veprimtarive të ndryshme.
 - parashikimet për politikën e cilësisë së shërbimeve – Në këtë dispozitë përcaktohet se si Këshilli i Ministrave do të miratojë politikën për nxitjen e ofruesve të shërbimeve për të përmirësuar cilësinë e tyre. Këto politika përfshijnë, pa u kufizuar në: skema vullnetare të certifikimit, zhvillimin e trajnimeve dhe ndarjen e praktikave më të mira. Gjithashtu, kjo dispozitë përcakton mënyrën e komunikimit ndërmjet autoriteteve kompetente dhe Komisionit, me qëllim inkurajimin e organizatave profesionale për të bashkëpunuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.
 - parashikimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve - Kjo dispozitë kërkon që ofruesit e shërbimeve të sigurojnë informacion të plotë kontakti dhe të përgjigjen shpejt ndaj ankesave. Gjithashtu, garanton saktësinë e informacionit të dhënë, një garancitë

financiare nga shtetet anëtare dhe detyron ofruesit të informojnë përfituesit mbi mekanizmat jashtëgjyqësorë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

- Neni 13 parashikon një kre të ri në lidhje me bashkëpunimin ndërinstitucional mes institucioneve të Bashkimit Evropian - Direktiva e Shërbimeve inkurajon bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kompetente ndarjen e informacionit, koordinimin e përpjekjeve rregullatore dhe adresimin e çdo pengese për lirinë e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve. Nenet e këtij kreu parashikojnë krijimin e një koordinatori kombëtar për ndërveprimin me Sistemin e Informacionit të Tregut të Brendshëm (IMI), si dhe pikat e ndërlidhjes për çdo autoritet kompetent. Gjithashtu, përcaktohet ndihma e ndërsjellë midis vendeve anëtare, rastet e mbikëqyrjes për zhvillimin e ofruesve të shërbimeve në shtete të tjera, si dhe masat paralajmëruese për veprimtari të shërbimeve që mund të dëmtojnë shëndetin ose sigurinë e personave. Po ashtu, përshkruhen mekanizmat e njoftimit dhe bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve për të garantuar zbatimin e rregullave dhe mbrojtjen e përfituesve të shërbimeve.
- Nenet e fundit parashikojnë afatet për miratimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave për hartimin e akteve nënligjore si dhe dispozitat tranzitore për hyrjen në fuqi të neneve të këtij projektligjit. Vlen të theksohet se pjesa më e madhe e tyre do të kushtëzohet me anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Në çdo rast, duhet theksuar që ky projektligj synon që për një pjesë të mirë të dispozitave, në veçanti ato të lidhura drejtpërdrejtë me shërbimet ndërkufitare, të parashikojë fillimin e efekteve vetëm me anëtarësimin e plotë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Kjo qasje bazohet në vlerësimin e përvojave të mëparshme të transpozimit të direktivës në vende me një rrugëtim të ngjashëm me atë të Shqipërisë. Në këtë rast, është ndjekur shembulli i Kroacisë si një model referimi për procesin e përafrimit dhe zbatimit të legjislacionit.

Në vitin 2011 (dy vite përpara anëtarësimit) shteti kroat adaptoi ligjin nr. 80/2011 “Për Shërbimet”, i cili transpozonte në tërësi gjithë parashikimet e Direktivës së Shërbimeve. Në secilën prej këtyre parashikimeve të cilat mund të ishin të paaplikueshme deri në momentin e anëtarësimit kishte një shënim shoqërues rreth nisjes së efekteve për këtë parashikim. Kjo qasje është ndjekur, ndër të tjera edhe për parashikimet në lidhje me shërbimet ndërkufitare.

Vlerësojmë se një praktikë e tillë është e përshtatshme dhe për situatën aktuale të Shqipërisë. Rrjedhimisht, fokusi i ndërhyrjes do të jetë përgatitja e ligjit për të qenë i efektshëm në tërësinë e tij vetëm pas anëtarësimit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Zbatimi, koordinimi dhe monitorimi do të kryhet nga ana e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit – për ndryshimet e propozuara dhe ligjin në tërësi si dhe veçanërisht në kuadër të implementimit në nivel vertikal, për përshtatjen e parashikimeve në aktet nënligjore përkatëse sa i takon legjislacionit sektorial. Kjo, në përputhje me aktet e miratuar enkas për këtë proces, saktësisht me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 300, datë 5.4.2017 “Për procedurën e njoftimit dhe formën e vlerësimit të përputhshmërisë së projektakteve të reja sektoriale me ligjin nr. 66/2016, “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë”.

Për sa më sipër, të përfshirë në proces janë ministritë e linjës, institucione të pavarura, institucione të ndërruara si dhe institucione të qeverisjes vendore, sipas fushave dhe sektorëve të tyre të veprimit. Saktësisht, institucionet e përfshira konsistojnë në:

1. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
2. Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar
3. Ministria e Drejtësisë
4. Dhoma Kombëtare e Avokatisë
5. Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit
6. Dhoma Kombëtare e Noterëve
7. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
8. Ministria e Financave
9. Dhoma Kombëtare e Zejtarisë
10. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
11. Bordi i Mbikëqyrjes Publike dhe Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
12. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale
13. Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit
14. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë
15. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
16. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
17. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
18. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
19. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

20. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
21. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
22. Enti Rregullator i Energjisë
23. Agjencia për Eficencën e Energjisë
24. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
25. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
26. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
27. Urdhri i Psikologut
28. Urdhri i Punonjësve Socialë
29. Ministria e Brendshme
30. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
31. Ministria e Arsimit dhe Sportit
32. Shoqatat Sportive
33. Federata Shqiptare e Futbollit
34. Federata Shqiptare e Basketbollit
35. Federata Shqiptare e Shahut
36. Federata Shqiptare e Taekëondo
37. Federata Shqiptare Alpinizmit dhe Turizmit Malor
38. Federata Shqiptare e Boksit
39. Federata Shqiptare e Peshëngritjes
40. Federata Shqiptare e Çiklizmit
41. Federata Shqiptare e Notit
42. Federata Shqiptare e Judos
43. Federata Shqiptare e Mundjes
44. Federata Shqiptare e Radioamatorizmit
45. Federata Shqiptare e Volejbollit
46. Federata Shqiptare e Sportit Shkollor
47. Federata Shqiptare e Tenisit
48. Autoriteti i Mediave Audiovizive

49. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

50. Banka e Shqipërisë.

Natyrisht që institucionet me rolin më proaktiv konsiderohen:

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)

Aktualisht MEKI është përgjegjëse sipas ligjit për të drejtuar e për të koordinuar procesin e shqyrtimit të legjislacionit sektorial për përputhshmëri me Ligjin për shërbimet dhe *acquis* përkatës, si dhe për të garantuar që asnjë iniciativë e re rregullatore të mos cenojë parimet e mësipërme. Kjo realizohet përmes një sistemi të dedikuar njoftimi të akteve të reja rregullatore apo ndryshimeve të atyre ekzistuese pranë MEKI, e cila miraton projekt aktet që rezultojnë në përputhje me Ligjin për shërbimet ose rekomandon ndryshimet e nevojshme, sipas rastit

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)

QKB shërben si pikë e vetme kontakti për regjistrimin e biznesit dhe licencimin dhe institucion kyç në kuadër të bashkëpunimit administrativ.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)

AKSHI është administratori i sistemit e-Albania, i cili operon si sportel me një ndalesë për ofruesit e shërbimeve dhe përfituesit e tyre, duke ofruar informacion mbi kërkesat për qasje dhe ushtrim të aktivitetit të shërbimit, detajet e kontaktit të autoriteteve kompetente që rregullojnë qasjen në treg për aktivitetet përkatëse të shërbimit, shoqatat apo organizatat nga të cilat ofruesit dhe marrësit mund të marrin ndihmë, mjetet juridike në rast mosmarrëveshjeje dhe mundësinë për të përfunduar procedura dhe formalitete online për të qasur apo ushtruar aktivitetin përkatës të shërbimit.

Me bërjen efektive të pjesëmarrjes së Shqipërisë në Sistemin e Informacionit të Tregut të Brendshëm (Internal Market Information System - IMI), bazën e të dhënave *online* që lehtëson shkëmbimin e informacionit midis autoriteteve publike të përfshira në zbatimin praktik të ligjit të Bashkimit Evropian, i cili rregullohet nga Rregullorja (BE) Nr. 1024/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 25 tetor 2012, mbi bashkëpunimin administrativ përmes sistemit IMI, pritët që AKSHI të marrë një rol edhe më të rëndësishëm për të mundësuar dhe garantuar ndërlidhjen dhe komunikimin në kohë reale me sistemin IMI, si dhe përshtatjen dhe modernizimin e bazave shtetërore të të dhënave.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji u hartua nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në bashkëpunim me GIZ, në kuadrin e projektit Saneca II dhe ekspertët e kontraktuar për këtë qëllim.

Ky draft është hartuar me mbështetjen e GIZ dhe është konsultuar nga grupi i punës me përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Projektligji do të dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Financave, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Shtetit dhe Kryenegociator, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshillit të Lartë Gjyqësor, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencisë për Mbikëqyrjen e Tregut (AKMT), Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Dhomës Kombëtare të Noterisë .

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka efekte financiare të menjëhershme në buxhetin e shtetit. Aktet e parashikuara për ndryshim janë evidentuar në raportin screening dhe kostot buxhetore do të evidentohen me përcaktimin e programit të punës për rishikimin e tyre.

Ndikimi buxhetor i vete ligjit do të evidentohet me hyrjen e në fuqi të dispozitave të tij pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

KËSHILLI I MINISTRAVE